

UNMIK/RREG/2002/1
24.01.2002

RREGULLORE NR. 2002/1

**NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/20 PËR MBROJTJEN E
PALËVE TË DËMTUARA DHE TË DËSHMITARËVE NË PROCEDURËN PENALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999)
të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të
Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi
Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr.
1999/24 të datës 12 dhjetor të vitit 1999 për Ligjin në fuqi në Kosovë.

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/20 të datës 20 shtator 2001 mbi Mbrojtjen
e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve në procedurën penale,

Duke pranuar faktin se frikësimi i palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve minon seriozisht
mundësitë për hetimin dhe ndjekjen efikase të krimeve të rënda në Kosovë, duke përfshirë
krimet ndëretnike dhe krimin e organizuar dhe se kjo paraqet një pengesë mjaft të madhe për
liggjshmërinë në Kosovë,

Me anë të kësaj Rregulloreje ndryshohet neni 8 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/20 me
qëllim të revidimit dhe sqarimit të mundësisë për zbatimin e kësaj Rregulloreje:

Neni 1
Ndryshimi

Neni 8 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/20 do të ketë formulimin e mëposhtëm duke
filluar nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Kjo Rregullore do të vlejë gjithashtu edhe për procedurat penale të filluara ndërmjet
datës 10.6.1999 dhe datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 2
Hyrja në Fuqi

Kjo Regullore hyn në fuqi me 24.1.2002.

Charles Brayshaw,
Ushtrues i detyrës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm